



KUVENDI KOMUNAL PRISHTINE * MUNICIPALIT ASSEMBLY PRISHTINA * SKUPSTINA OPSTINA PRISTINA

Në mbështetje të nenit 13.7 14,7, lidhur me nenin 16.2, dhe të nenit 19.2 të Ligjit për planifikim hapësinor nr.2003/14, të dt. 3.7.2003, të shpallur sipas Rregullores nr.2003/30, të dt.10.9.2003; të nenit 3, par.1, pika b, të Rregullores mbi vetëqeverisjen e komunave të Kosovës nr.2000/45, të dt.11 gusht 2000, të nenit 19, par.1, pika b, dhe të nenit 40, par.3, pika II. të Statutit dhe Rregullave të procedurës të Komunës së Prishtinës, të dt. 16.3.2001, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 23.11.2006 merr

V E N D I M

PËR MIRATIMIN E PROPOZIMPLANIT RREGULLUES “MATI III” PËR BANIM INDIVIDUAL NË PRISHTINË

Neni 1

Miratohet Propozimplanin rregullues për banim individual “Mati III” në Prishtinë. Propozimplanin, nga paragrafi 1 i këtij neni, përbëhet nga pjesa tekstuale dhe grafike, të cilat paraqesin pjesë përbërse të këtij Vendimi.

Neni 2

Me Propozimplanin rregullues, nga neni 1 i këtij Vendimi, rregullohet hapësira për banim individual “Mati III” në Prishtinë.

Hapësira, nga par.1 i këtij neni, përfshinë ngastrat kadastrale nr. 112, 145, 146, 151, 153/1, 153/2, dhe 160/2, Zona kadastrale “Mati III”, të evidencuar në fletën poseduese nr. 525, me një sipërfaqe të përafërt prej 43,00 ha.

Neni 3

Propozimplanin, nga neni 1 i këtij Vendimi, duhet t`i nënshtrohet shqyrtimit publik. Shqyrtimi publik i Propozimplanit rregullues, sipas këtij Vendimi, zgjatë 30 ditë, duke filluar nga dita e parë vijuese pas miratimit të tij nga Kuvendi i Komunës së Prishtinës.

Neni 4

Pas përfundimit të shqyrtimit publik të Propozimplanit, nga neni 1 i këtij Vendimi, Drejtorati i Planifikimit, Urbanizmit dhe i Ndërtimitarisë do të kryejë veprimet e parapara ligjore për finalizimin e këtij plani, në mënyrë që i njëjti t`i prezantohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim përfundimtar.

Neni 5

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Bordi i drejtorëve të Komunës së Prishtinës.

Neni 6

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e miratimit të tij nga Kuvendi i Komunës së Prishtinës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01.Nr. 35-546, më 23.11.2006

KRYETARI I KUVENDIT
Ismet Beqiri